



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2740/Prot.
5

Tiranë, më 12/10 /2023

URDHËR

Nr. 150, datë 12.10.2023

“PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 145, DATË 29.09.2023 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 2, datë 14.09.2023 “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në shkresën dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2740/4 prot., datë 11.10.2023 “Njoftim shpallje për konkurrim, personel akademik me kohë të pjesshme ...” si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 145, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e paragrafit të tretë, të pikës 11, të shkronjës B. të shtojcës nr. 1 të Urdhrit nr. 145, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:

Ishte:

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë zyrës së Protokoll – Arkivës në Njësinë Kryesore (Fakultet) ku kandidati aplikon, fizikisht ose nëpërmjet shërbimit postar me listë inventari. Afati është 7 (shtatë) ditë me ditën e shpalljes në faqen zyrtare të UMT-së.

Bëhet:

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë zyrës së Protokoll – Arkivës në Njësinë Kryesore (Fakultet) ku kandidati aplikon, fizikisht ose nëpërmjet shërbimit postar me listë inventari.

Afati i aplikimit është 7 (shtatë) ditë kalendarike, afat i cili fillon nga e nesërnia e shpalljes së njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2. Ndryshimin e paragrafit të katërt, të pikës 11, të shkronjës B. të shtojcës nr. 1 të Urdhrit nr. 145, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:

Ishte:

Të gjithë të interesuarit duke filluar nga data 02.10.2023 të vizitojnë faqet zyrtare të internetit të Fakulteteve dhe atë të UMT-së , me qëllim me njohjen me kriteret specifike, afatet dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë (përfshirë dokumentacionin specifik) për të konkurruar për personel akademik me kohë të pjesshme(Pedagogë të jashtëm), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Bëhet:

Të gjithë të interesuarit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së, mbi shpalljen për konkurrim, personel akademik me kohë të pjesshme (Pedagogë të Jashtëm), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të vizitojnë faqet zyrtare të internetit të Njësive kryesore (fakulteteve) dhe atë të UMT-së , me qëllim me njohjen me kriteret specifike, afatet dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë (përfshirë dokumentacionin specifik) për të konkurruar për personel akademik me kohë të pjesshme(Pedagogë të jashtëm), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë të marrim masat përkatëse për ripublikimin e kriterëve, afateve dokumentacionit dhe të procedurës për konkurrim për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024, menjëherë me publikimin e njoftimit në buletin e APP-së.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

ARBEN GJATSHI

